

ANALIZA E EKSPERTËVE

Shkeljet e procedurës ligjore
të procesit politik ndaj kreut
të opozitës shqiptare, Sali Berisha

PËRGATITUR NGA :

Sokol Mëngjesi

Genc Gjokutaj



www.sali-berisha.com

Shkeljet e procedurës ligjore evidentojnë procesin e montuar politikisht ndaj kreut të opozitës shqiptare, Sali Berisha.

Sokol Mëngjesi ¹, Genc Gjokutaj²
Avokatët Mbrojtës të Sali Berishës

I. Informacion i përmbledhur

1. Ndaj kreut të opozitës Sali Berisha është montuar procesi politik i çështjes së Klubit Sportiv Partizani. Çështja ka të bëjë me një tokë që iu njoh e iu kthye, në përputhje me ligjin, ish-pronarëve të saj, të shpronësuar nga regjimi komunist 60 vjet më parë, si dhe me privatizimin, në përputhje me ligjin, të ndërtesave të rrënuara e jashtë funksionit të klubit. Në mesin e qindra trashëgimtarëve të familjeve të origjinës, që përfituan nga kthimi i pronës së tyre, ishte Jamarbër Malltezi, dhëndri i z.Berisha, i cili trashëgoi 410 m² nga familja e tij. Dosja hetimore e klubit Partizani është një piramidë mashtrimi, bazuar në fshehjen dhe falsifikimin e qindra dokumenteve zyrtare, manipulimin e provave dhe refuzimin e pranimit të provave në dosje nga drejtësia e kontrolluar politikisht.

2. Hetimi për çështjen u hap në bazë të një padie me pretendime të rreme, të ngritur nga kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, sot ministër i Brendshëm, Taulant Balla. Vulat zyrtare tregojnë se Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK) ka regjistruar hapjen e hetimit në të njëjtën ditë në të cilën është regjistruar zyrtarisht padia, duke treguar se hapja e hetimeve nuk është bërë në bazë të vlerësimit të çështjes sipas ligjit, por sipas urdhrit politik. Hetimi tre vjeçar nuk nxorri asnjë provë apo dokument që të tregonin qoftë edhe një shkelje të procesit të njohjes dhe kthimit të tokës, të cilat zgjatën gati 15 vjet (1994 – 2007), apo të procesit të privatizimit, i cili u fillua nga qeveria e Partisë Socialiste (PS) në 2005 dhe përfundoi nga qeveria e Partisë Demokratike (PD) në 2008. Përkundrazi, të dukshme u bënë kallzimet e rreme të Taulant Ballës, por SPAK nuk pranoi t'a bënte atë përgjegjës për kallzim të rremë, në zbatim të nenit 305 dhe 305/a të Kodit Penal. Ky proces hetimor u regjistrua në lidhje me çështjen, jo mbi një emër/person të caktuar, por faktikisht u fokusua thujse ekskluzivisht mbi Berishën dhe Malltezin. Duke qenë se zyrtarisht ata nuk ishin persona nën hetim, gjatë kësaj faze hetimi të përqëndruar ndaj tyre, atyre iu mohuan të drejtat procedurale që ligji u njeh personave nën hetim. Gjatë tre viteve të hetimit Berisha dhe Malltezi nuk u thirrën kurrë nga SPAK për t'u marrë në pyetje për

¹Prof.Dr.Sokol Mëngjesi është ish-dekan i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, pedagog i së Drejtës Penale dhe anëtar i Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë.

²Genc Gjokutaj është ish-zëvendësprokuror i rrethit dhe anëtar i Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë.

këtë çështje, sepse kjo do të nxirrte menjëherë në shesh piramidën e mashtrimit politik që SPAK po ndërtonte me porosi politike. Pas thirrjeve të përsëritura publike të Edi Ramës në maj dhe prill 2022ⁱ, ku ai urdhëroi SPAK-un të hetonte Berishën, SPAK intensifikoi veprimet procedurale ndaj Berishës dhe dhëndrit të tij dhe hapi hetimin e kësaj çështjeje duke i marrë ata zyrtarisht nën hetim. Ndërkohë që hetimi ndaj tyre sapo kish filluar, SPAK dhe GJKKO vendosën menjëherë ndaj tyre masat e sigurimit personal, të arrestit me burg për Malltezin, si dhe të ndalimit të daljes jashtë shtetit dhe detyrim paraqitjes për Berishën.

3. Ndër qindra zyrtarëve të emëruar nga qeveritë e PS-së apo PD-së, të cilët kanë kryer në zbatim të ligjit procesin e njohjes dhe kthimit të titullit të pronësisë, si dhe privatizimin e objekteve të ndërtuara në tokën e tyre, tek qindra pronarë të ligjshëm, njëri prej të cilëve ishte z.Malltezi, asnjë prej tyre nuk është nën hetim, sepse ata kanë zbatuar me rigorozitet ligjin. Shteti nuk ka pësuar asnjë dëm financiar në këtë proces, ndërkohë që pronarëve legjitimë u është kthyer prona.

4. Vendimi për caktimin e masave të sigurimit personal të ndalimit të udhëtimit jashtë vendit dhe detyrim paraqitjes ndaj kryetarit të PD-së Sali Berisha, pa autorizimin paraprak të Kuvendit, në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin dhe precedentët e mëparshëm, si dhe zëvendësimi i këtyre masave me arrest shtëpie, pa dërguar asnjë provë në Kuvend, jo vetëm që dëshmon standardet e dyfishta që zbatohen ndaj opozitës, por përbën dhe një shkelje flagrante të Kushtetutës dhe të Kodeve Penale. Po kështu miratimi i autorizimit për vendosjen e Berishës në arrest shtëpie pa respektuar garancitë ligjore minimale, vendosja, pa një dispozite mbështetëse ligjore, e ndalimit të komunikimit me këdo, përveç familjarëve me të cilët bashkëjeton, kufizimi i pjesëmarrjes në seancat parlamentare pa vendim gjykate, janë të gjitha shkelje të dukshme të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parimeve të procesit të rregullt ligjor, gjykimit të drejtë dhe sigurisë juridike, të garantuara edhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

5. Këto shkelje flagrante janë kryer nga Prokuroria e Posaçme (SPAK), Gjykata Speciale (GJKKO) dhe Parlamenti i kontrolluar nga Edi Rama, nën diktat publik të këtij të fundit mbi këto institucione, me qëllim dobësimin e opozitës në vend dhe largimin e Sali Berishës nga gara në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Ato janë vënë në zbatim, në një sërë shkeljesh ligjore, të evidentuara në këtë raport, nga prokurorë dhe gjyqtarë, të cilët sipas ligjit kishin detyrimin të tërhiqeshin nga çështja ose të largoheshin, për shkak të vendimeve të mëparshme të shkarkimit të tyre nga detyra prej z.Berisha, ose të konfliktit të interesit për shkak të akuzave publike të Berishës ndaj tyre për lidhje me krimin e organizuar.

*** Për detaje të mëtejshme** mbi mungesën e shkeljeve të ligjit dhe provave në dosjen e Klubit Partizani, si dhe për fshehjen e dokumentave nga SPAK, ju lutemi të vizitoni faqen web:
<https://www.sali-berisha.com/shqip-arrestimi-politik>

II. Shkeljet e kryera nga Prokuroria Speciale për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK), Gjykata Speciale për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) dhe Parlamenti i kontrolluar nga Edi Rama.

6. Që prej datës 30.12.2023, Sali Berisha, ish-president dhe ish-kryeministër i Shqipërisë, deputet dhe kreu i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ndodhet në arrest shtëpie, si dhe nën urdhër ndalim komunikimi me këdo, përveç anëtarëve të familjes që jetojnë me të, ndalim ky i vendosur në kundërshtim me kushtetutën, e cila përcakton se ndalime të tilla mund të vendosen vetëm nëse janë të parashikuara në ligj, ndërkohë që legjislacioni penal nuk përmban asnjë dispozitë ligjore që parashikon një ndalim të tillë. Gjithashtu, në kundërshtim me kushtetutën, ligjin, si dhe në mungesë të një vendimi gjyqësor, atij i ndalohej edhe pjesëmarrja në seancat parlamentare. Masat shtrënguese ndaj tij u vendosën në fazën e hetimit, duke kryer një sërë shkeljesh të rënda të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe kodeve të vendit, pa ngritur asnjë akuzë kundër tij dhe para se SPAK t'a merrte në pyetje mbi ndonjë shkelje të pretenduar.

7. Më datë 20.10.2023, GJKKO (shkalla e parë) me vendimin nr. 112 datë 20.10.2023, vendosi ndaj Sali Berishës dy masa të kufizimi të lirisë: ndalim të daljes jashtë vendit dhe detyrim paraqitje dy herë në muaj para prokurorisë. Me të njëjtin vendim u caktua dhe u ekzekutua në mënyrë brutale, transmetuar në media për hakmarrje politike, arresti me burg ndaj dhëndrit të tij, Prof. Dr. Jamarbër Malltezi. Vendimi për zotin Berisha u konfirmua nga e njëjta gjykatë, me vendimin nr. 117 datë 26.10.2023.

8. Pas një padie të bazuar në kallzim të rremë, nga kreu i grupit parlamentar të PS-së, aktualisht ministër i Brendshëm, Taulant Balla, SPAK rregjistroi në të njëjtën ditë, në kundërshtim me ligjin, çeljen e hetimeve. Hetimi i regjistruar mbi çështjen Partizano (jo për ndonjë person të caktuar), i cili vazhdoi për tre vjet, në fakt u fokusua tërësisht ndaj hetimit pasuror të Berishës dhe Malltezi, duke u mohuar këtyre të fundit çdo të drejtë procedurale, pasi formalisht ata nuk ishin persona nën hetim.

9. Tre vitet e hetimit nuk nxorën asnjë provë për ndonjë shkelje ligjore në lidhje me këtë dosje. Megjithatë, në tetor 2023, SPAK nisi hetimet për këtë çështje ndaj Berishës dhe Malltezi dhe vendosi menjëherë masa shtrënguese ndaj tyre, pa ngritur padi. Ndërkohë që Berisha dhe Malltezi janë nën hetim për korrupsion, të kryer në bashkëpunim, SPAK e GJKKO, në shkelje të parimit të sigurisë juridike, si dhe të kriterëve ligjore të vendosura nga Kodi i Procedurës Penale (KPP), nuk kanë treguar në asnjë dokument se cilat janë veprimet e paligjshme që kanë kryer personat nën hetim. Asnjë nga aktet e përshkruara në vendimin e gjykatës nuk është i paligjshëm dhe asnjë shkelje ligjore nuk është konstatuar në procesin e njohjes dhe kthimit të tokës pronarëve të ligjshëm, si dhe privatizimit të objekteve të rrënuara të klubit sportiv Partizani. Berisha nuk ka asnjë firmë, asnjë rol në asnjë nga proceset e njohjes dhe kthimit të pronës, apo privatizimit të

objekteve të rrënuara. Asnjë nga zyrtarët që kanë kryer këto procese nuk është nën hetim për shkak se nuk është kryer asnjë shkelje.

10. Kriteret e konsoliduara doktrinare dhe jurisprudenciale mbi elementët e veprave të korrupsionit janë shpërfillur plotësisht nga SPAK dhe GJKKO, të cilët nuk kanë ofruar asnjë analizë të tillë. Masat e sigurimit personal u vendosen në kundërshtim si me kriteret ligjore të caktimit të tyre, ashtu edhe me precedentët e marrjes së autorizimit para vendosjes së masave të tilla. Interpretimi *sui generis* i ligjit dhe shkelja e precedentëve, duke cënuar kështu parimin e sigurisë juridike, u përdorën si armë kundër opozitës, për të larguar Berishën, të cilin Edi Rama e sheh si pengesë në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme.

11. Masat e sigurimit personal u vendosën, gjatë fazës së hetimit, në kundërshtim flagrant me Kodin e Procedurës Penale (KPP), neni 245§1(ç)ⁱⁱ, pa i thirrur asnjëherë në pyetje Berishën dhe Malltezin në lidhje me dyshimet ndaj tyre dhe pa dëgjuar asnjëherë argumentat e tyre.

12. Në caktimin e tyre nuk u plotësuan as kriteret e kërkuara nga nenet 228 dhe 229ⁱⁱⁱ të KPP (*të cilat diskutohen më poshtë*).

13. Masat ndaj Berishës u caktuan në shkelje flagrante të garancive kushtetuese, të cilat parashikojnë imunitet për deputetët. Masat që kufizojnë lirinë e deputetëve, kontrollin e banesës, si dhe liri të tjera kushtetuese, si liria e shprehjes dhe e ushtrimit të funksioneve thelbësore të deputetit, kërkojnë dhënien *ex-ante* të autorizimit nga Kuvendi (neni 73 i Kushtetuta e Shqipërisë^{iv}, nenet 13§5^v dhe 118 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë^{vi}, neni 288§1, §2 i KPP).

14. Masat e sigurimit personal ndaj Berishës u vendosën në kundërshtim me këto garanci dhe precedentë e mëparshëm, pa kërkuar autorizimin e Kuvendit. Të njëjtat masa nuk janë marrë asnjëherë ndaj një deputeti pa autorizimin e Kuvendit. Për ilustrim, autorizimi nga Kuvendi u kërkuar nga prokuroria dhe u citua nga gjykata si një nga kushtet e vendosjes së ekzaktesisht të njëjtave masa ndaj deputetit të Partisë Socialiste Saimir Tahirit (vendimi i Kuvendit nr. 104/2017, datë 25.10.2017^{vii}).

15. Vendimet nr. 112 datë 20.10.2023 dhe nr. 117 datë 26.10.2023, nuk iu njoftuan asnjëherë personalisht z.Berisha, siç e kërkon neni 246 i KPP^{viii}, pra ligjërisht ato nuk hynë asnjëherë në fuqi. Megjithatë, gjykatat e injoruan këtë aspekt dhe shkelje të tjera flagrante të të drejtave të njeriut dhe garancive procedurale.

16. Gjykata Speciale e Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizuar i la në fuqi këto masa, pavarësisht shkeljeve të dukshme.

17. Gjyqtarja Maneku Gjoka nuk respektoi as garancitë minimale të një procesi të drejtë ligjor, të sanksionuara në ligjet themelore të shtetit. Në kundërshtim me kushtetutën dhe precedentët e krijuar, ajo hodhi poshtë kërkesën e avokatëve mbrojtës për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 145 të kushtetutës^{ix}, për të vlerësuar nëse autorizimi i parlamentit duhej kërkuar para vendosjes së masave të sigurisë personale.

18. Ajo refuzoi kërkesën e avokatëve mbrojtës për dorëheqjen e saj, bazuar në informacione se gjyqtarja ishte shkarkuar nga gjyqësori në vitin 1996, me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në kohën kur ky organ drejtohej nga Sali Berisha, si President i Republikës. Sipas nenit 17 të KPP, ajo kishte detyrimin të jepte dorëheqjen për shkak të rrethanave që cënonin paanshmërinë e saj, ndërkohë që neni 18 parashikon përjashtimin nga çështja për këto shkaqe, të gjyqtarit që nuk jep dorëheqjen vullnetarisht^x. Këto dispozita ligjore janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), për t'i garantuar kujtdo të drejtën për një proces të drejtë, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj.

19. Në kundërshtim me nenin 31(b) të Kushtetutës dhe nenin 34/a të KPP-së që i garanton çdokujt kohë dhe lehtësi për të përgatitur një mbrojtje efektive, si dhe me nenin 248§1 të KPP-së^{xi}, i cili u mundëson subjekteve nën hetim dhe mbrojtjes së tyre një periudhë kohore prej pesë ditësh për të përgatitur, lexuar dosjen dhe madje edhe për të bërë kopje të saj, gjyqtarja Maneku Gjoka refuzoi kërkesën e avokatëve mbrojtës për të përdorur kohën që u jep ligji për të lexuar dosjen dhe për të përgatitur mbrojtjen.

20. Gjyqtarja Maneku Gjoka u dha mbrojtësve të caktuar nga z.Berisha vetëm disa orë për të lexuar dosjen e lëndës prej 20.000 faqesh, gjatë së cilës ata nuk u lejuan as të fotografonin dokumentet. Kur ata nuk pranuan të kryenin detyrën e tyre pa u njohur me dosjen pre 40 vëllimesh, gjykata i përjashtoi ata nga seanca dhe vijoi procesin me avokatë të caktuar kryesisht.

21. Nga shkrimet e mediave u zbulua se avokati i parë që u caktua kryesisht nga gjyqtarja Maneku Gjoka kishte bërë deklaratat publike në Facebook, në të cilat sulmonte Sali Berishën, ndaj u largua nga çështja. Dy avokatët e tjerë, që u caktuan më pas nga gjyqtarja kryesisht, kërkuan që t'u jepej dy ditë kohë për të lexuar dosjet e lëndës. Gjyqtarja Maneku Gjoka refuzoi kërkesën dhe i kërcënoi ato në seancë se do t'u hiqte licensën e avokatit nëse nuk do të vazhdonin menjëherë me mbrojtjen. Avokatët refuzuan dhe gjyqtarja mori vendim për largimin e tyre.

22. Ajo caktoi një avokate tjetër kryesisht, znj. Valentina Teodoresku. Postimet në Facebook të znj. Teodoresku, të cilat u publikuan në media, tregonin se ajo ishte një mbështetëse aktive e kryeministrit Edi Rama dhe një admiruese e flaktë e Enver Hoxhës. Për më tepër, në statuset e saj ajo kish kërkuar publikisht në mënyrë të vazhdueshme arrestimin e Sali Berishës. Në postimin e saj në Facebook të datës 21.12.2021 thuhet: “Po vjen ora e arrestimit të Sali Berishës; Yuri Kim i kërkon publikisht Arben Krajës: SPAK duhet të veprojë tani!”. Gjithashtu, ajo ka ndarë thirrjet e Edi Ramës ndaj SPAK për arrestimin e zotit Berisha, si dhe postimin e Taulant Ballës për nisjen e po këtij hetimi penal pas padisë së tij. Emërimi i znj. Teodoresku ishte në kundërshtim jo vetëm me dispozitat e kushtetutës dhe të KPP-së që garantojnë të drejtën për një mbrojtje efektive, të cituar në paragrafin 19, por edhe me nenet 3 dhe 8 të ligjit nr.55/2018 “Për profesionin e avokatit mbrojtës në Republikën e Shqipërisë”^{xii}. Siç pritej, roli i saj si avokate mbrojtëse ishte fiktiv. Ajo ishte gati në 60 minuta për të vazhduar procesin, kohë kjo e pamjaftueshme për t'u përgatitur, pasi vetëm vendimi nr.112 i gjykatës ishte 200 faqe. Nga regjistrimet audio të seancës dëshmohet se znj. Teodoresku nuk ka ngritur asnjë argument për mungesën e kushteve ligjore për vendosjen e

masave të sigurisë ndaj zotit Berisha. Prandaj, këtij të fundit iu mohua e drejta për një mbrojtje efektive, e parashikuar edhe në nenin 6 të KPP^{xiii}.

23. Këto argumente u paraqitën, së bashku me shkaqe të tjera ankimimi, në Gjykatën e Posaçme të Apelit, por nuk u morën parasysh nga gjyqtarja Ilirjana Olldashi, e cila la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

24. Berisha refuzoi t'u bindej këtyre masave antikushtetuese, sepse po të vepronte ndryshe do të nënkuptonte pranimin e marrjes së kompetencave të parlamentit nga gjyqësori dhe do t'i jepte licencë çdo gjyqtari ose prokurori për të shkruar një kushtetutë sipas urdhrave të qeverisë. Garancitë kushtetuese mbi deputetët janë në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila ka njohur se imuniteti i dhënë nëpërmjet kushtetutës nuk u takon deputetëve si individë, por parlamentit, për të siguruar që veprimtaria e këtij të fundit të zhvillohet pa probleme dhe e mbrojtur nga presionet politike (*Kart kundër Turqisë, 8917/05*).

25. Pas refuzimit të Berishës për t'iu bindur masave antikushtetuese, prokurorët e SPAK iu drejtuan Kuvendit dhe kërkuan autorizimin për caktimin e masës së paraburgimit. Kjo kërkesë ishte e pabazuar në ligj, sepse nuk ishte kërkesë për vendosjen e masave të sigurimit personal në bazë të provave, por kërkesë për zëvendësimin e disa masave me masa më të ashpra, pa dhënë asnjë provë, por si formë dënimi për mos-zbatimin e masave të mëparshme. Jo rastësisht, rregullorja parlamentare nuk parashikon një procedurë të tillë. E vetmja procedurë e parashikuar është ajo e dhënies së autorizimit për masa të sigurimit personal, sipas kërkesës të bazuar në prova (shih seksionin III).

26. Megjithatë, mazhoranca e kontrolluar nga Partia Socialiste i dha SPAK autorizim, në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit (nenet 13§5 dhe 118) dhe me precedentë të tjerë.

27. Pas vendimit të mazhorancës parlamentare të PS-së, prokurorët i kërkuan gjykatës që ndaj Berishës të caktojë masën e arrestit të shtëpisë, si dhe ndalimin e komunikimit me këdo, përveç anëtarëve të familjes së tij të ngushtë që jetojnë me të.

28. Me vendimin nr . 520, datë 30.12.2023 të GJKKO, gjyqtarja Irena Maneku Gjoka, nxitoi të pranonte kërkesën e prokurorëve, në shkelje thelbësore të kushtetutës së vendit dhe kodit të procedurës penale (KPP), të shtjelluara në paragrafët pasues.

28.1. Masa arrest shtëpie u mor sërish pa e thirrur asnjëherë në pyetje z. Berisha, në kundërshtim me nenin 245§1 (ç), i cili e konsideron të pavlefshëm vendimin e gjykatës që cakton masën e sigurimit, i cili nuk paraqet arsyet e mospranimit të argumentave të mbrojtjes dhe arsyet për të cilat masat e tjera më të lehta konsiderohen të papërshtatshme. Z.Berisha nuk u mor asnjëherë në pyetje përpara se ndaj tij të jepej masa e arrestit të shtëpisë, gjykata nuk i dëgjoi kurrë argumentet e tij mbrojtëse dhe në vendimin e saj nuk shpjegohet pse argumentat e mbrojtjes

nuk merren parasysh. Vendimi gjithashtu nuk argumenton se përse masa më të lehta, si garancia pasurore dhe detyrimi për të qëndruar në një vend të caktuar nuk u konsideruan të përshtatshme.

28.2. Caktimi i masave është bërë në mungesë të dyshimeve të arsyeshme, të bazuara në prova, për ekzistencën e veprës penale, si dhe të kriterëve të parashikuara në nenin 228§3, KPP. Asnjë nga faktet që përmenden në lidhje me zotin Berisha nuk përbën shkelje ligjore, prandaj nuk ka dyshim të bazuar se ai ka kryer veprën penale. Veprat e supozuara kanë ndodhur 15-25 vjet para hetimit dhe provat janë akte publike, prandaj nuk ekziston rreziku i prishjes së tyre dhe gjykata nuk ka treguar se cilat janë rrethanat faktike që tregojnë rrezikun e prishjes së provave. Nuk ka asnjë rrezik që zoti Berisha të arratiset, gjë që pranohet edhe nga SPAK në seancën dëgjimore të Këshillit të Parlamentit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, datë 18.12.2023. Së fundmi, nuk ka asnjë rrethanë në të cilën mund të përsëritet e njëjta veprë penale sepse zoti Berisha është në opozitë dhe nuk ka pushtet administrativ.

28.3. Kushti procedural për zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga gjykata nuk ekzistonte, pasi vendimi i Kuvendit ishte antikushtetues. Kërkesa e SPAK-ut drejtuar Kuvendit ishte e paprecedentë dhe e pabazuar në ligj, pasi në kundërshtim me regjimin ligjor, ndërhyrja e Kuvendit nuk u kërkua për vendosjen e masave të sigurimit personal të bazuara në prova, por si ndëshkim për shkak se z. Berisha nuk iu bind masave antikushtetuese të vendosura me vendimin nr. 112 datë 20.10.2023 dhe nr. 117 datë 26.10.2023 të GJKKO-së. Pra, vendimi i Këshillit Parlamentar për Këshillin Mandat për Rregulloren, është marrë në mungesë të procedurës së përcaktuar me ligj. Vendimet nr.112 dhe nr.117 nuk i janë paraqitur asnjëherë personalisht z.Berisha, siç e kërkon ligji. Ato nuk hynë kurrë në fuqi, ndaj z.Berisha nuk është përgjegjës për mos-zbatimin e tyre.

28.4. Vendimi nr.520, datë 30.12.2023, bie ndesh me kushtet ligjore për zëvendësimin e masave të sigurimit personal, të parashikuara në nenet 231 dhe 260 të Gjykatës së Procedurës Penale (KPP). Neni 231 i KPP ^{xiv}, mundëson rëndimin e masave të sigurimit personal vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e përcaktuara ligjore. Sipas dispozitës, masa shtrënguese nuk mund të ashpërsohet vetëm për shkak të mospërbushjes formale, por prokurori **mund** të kërkojë një masë më të ashpër bazuar në tre kriteret: rëndësinë e mospërbushjes, motivet dhe rrethanat e moszbatimit.

2 8.4.1. Lidhur me kriterin e parë – rëndësinë e shkeljes së masës së parë, ekziston një qëndrim i konsoliduar i jurisprudencës (i cituar edhe nga gjykata) se jo çdo mospërbushje mund të ketë si pasojë rëndimin e masave të sigurimit, por vetëm ato qëndrime që vënë në rrezik hetimin ose rrisin rrezikun e largimit. Zoti Berisha ka qenë çdo ditë në TV gjatë kësaj periudhe dhe SPAK as që e pretendon se ekziston rreziku i largimit. Provat në këtë rast janë akte publike të 15-20 viteve më parë, pra rreziku i prishjes së hetimit është inekzistent.

28.4.2. Motivi i z. Berisha për refuzimin për t'iu bindur masave të para ishte vendosmëria e tij për të respektuar ligjin themelor të vendit – kushtetutën.

28.4.3. Kriteri i rrethanave gjithashtu nuk përmbushet për të justifikuar ashpërsimin e masave, pasi ndërkohë që ka sfiduar masat antikushtetuese të vendosura nga gjykata, zoti Berisha ka vijuar veprimtarinë e tij politike intensive dhe publike, e nuk ka kryer asnjë veprimtari të kundërligjshme.

28.4.4. Në kundërshtim me nenin 260 të KPP, masat e sigurimit personal nuk u përshkallëzuan për shkaqet e parashikuara në ligj, por si dënim dhe me qëllim kufizimin e lirive politike të zotit Berisha. Në kërkimin e masës së arrest shtëpie, prokurorët e SPAK-ut anashkaluan dy masa të tjera më të lehta që mund të kishin zbatuar, konkretisht garancinë pasurore dhe ndalimin e detyrimit për të qëndruar në një vend të caktuar (neni 232 i KPP^{xv}). Është e qartë se kapërcimi në nenin 232(d), ndërkohë që u anashkaluan dy masa të tjera më të lehta (neni 232c&ç), i shërben interesit politik të kryeministrit Edi Rama për të dobësuar opozitën shqiptare.

28.5. Vepra e supozuar, pra pretendimi se zoti Berisha nuk i ka zbatuar masat e para të sigurisë, nuk ekziston, sepse z. Berisha asnjëherë nuk është informuar zyrtarisht në një nga mënyrat e përcaktuara nga KPP për këto vendime.

28.6. Vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurisë ishte i pavlefshëm në kuptim të nenit 128/a^{xvi} të KPP-së, për shkak të mosrespektimit të mënyrës së caktuar me ligj për caktimin e gjyqtarit të çështjes dhe dispozitave që kanë të bëjnë me thirrjen e detyrueshme të personit nën hetim.

28.7. Vendimi nr.520, datë 30.12.2023, është dhënë në kundërshtim me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, të paanshme dhe të pavarur.

28.7.1 Avokatët e z. Berisha kërkuan përjashtimin e gjyqtarës së çështjes nga ky proces për shkak të cënimit të kriterit të gjykatës së paanshme. Në këtë moment ata dispononim dhe i paraqitën gjykatës prova zyrtare që vërtetonin se gjyqtarja Maneku Gjoka ishte shkarkuar për paafësi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në vitin 1996, kur Berisha ishte President dhe Kryetar i Këshillit.

28.7.2. Në kundërshtim me ligjin, gjyqtarja Maneku Gjoka, e cila është dhe kryetare e GJKKO-së, këtë kërkesë për përjashtim nuk ia kaloi për gjykim gjyqtarit të gatshëm dhe as nuk caktoi një gjyqtari tjetër me short, siç është rregull në çdo gjykatë në Shqipëri. Në vend të kësaj, ajo kapërceu emërimin tek gjyqtari që mesa duket i dha garanci për rrëzimin e kërkesës së avokatëve mbrojtës. Kjo shkelje cenon parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, që është parim i qenësishëm i legjislacionit shqiptar, si dhe i nenit 6 të KEDNJ, në të cilën Shqipëria është palë. Siç pritej, gjyqtari i përzgjedhur e rrëzoi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës Maneku Gjoka.

28.7.3. Avokatët e z. Berisha kërkuan sërish shkarkimin e gjyqtarës Maneku Gjoka në bazë të nenit 17§1 (ë) të KPP, duke dhënë si arsye shkeljet e rënda të përsëritura të ligjit nda ana e saj. Këto shkelje, të cilat iu bashkangjiten kërkesës, përfshinin faktin se 1) të gjitha

kërkesat e mbrojtjes ishin hedhur poshtë nga gjyqtarja, ndërsa të gjitha kërkesat e prokurorisë ishin pranuar; 2) ishin refuzuar provat e paraqitura nga mbrojtja; 3) vendimet e gjykatës nuk ishin të bazuara në ligj; 4) vendimet nuk ishin të arsyetuara në lidhje me argumentet e mbrojtjes; në fakt, shumë nga argumentet e mbrojtjes nuk përmenden fare në vendimin e gjykatës.

28.7.4. Neni 18§2 i KPP përcakton se gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit derisa të jepet vendimi që e deklaron të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përjashtimit^{xvii}. Në kundërshtim me ligjin, gjyqtarja vendosi menjëherë të vazhdojë pranimin e kërkesës së SPAK për arrest shtëpie për zotin Berisha, si dhe ndalimin e komunikimit mes tij dhe kujtdo tjetër, përveç familjarëve të tij të ngushtë që jetojnë me të.

28.8 Masa arrest shtëpie u vendos në kundërshtim me kriteret ligjore të vendosura nga KPP për dhënien e një mase të tillë, siç është përshkruar më sipër.

28.9. Vendimi vendosi kufizime të paargumentuara të të drejtave dhe lirive kushtetuese (liria e shprehjes), të cilat ishin joproporcionale dhe të pambështetura në ligj.

28.9.1. Ndalimi i komunikimit përbën një shkelje flagrante e Kushtetutës së vendit, e cila në nenin 17^{xviii} përcakton se kufizimet e të drejtave kushtetuese mund të bëhen vetëm në bazë të ligjit. Dispozita e Kodit të Procedurës Penale, e cila lejonte gjykatat të kufizonin lirinë e komunikimit të një personi (neni 237) është ndryshuar në vitin 2017 dhe ndalimi i komunikimit u hoq pasi u konsiderua në kundërshtim me KEDNJ. Prandaj, vendimi i dhënë nga gjykata, në kundërshtim me kriterin kushtetues, është i pambështetur në ligj.

28.9.2. Ndalimi i komunikimit me persona të tjerë, përveç anëtarëve të familjes që jetojnë me të, është më i rreptë se regjimi i vendosur ndaj personave në qendrat e paraburgimit, të cilët mund të takohen me një gamë më të gjerë familjarësh, si dhe mund të takohen me gazetarë dhe deputetë. Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajnimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgim”, neni 49, përcakton të drejtën e të burgosurit për t’u takuar me familjarët. Nocioni i anëtarëve të familjes, sipas nenit 3, përfshin një gamë më të gjerë sesa njerëzit që jetojnë nën të njëjtin kulm, siç ka vendosur gjykata për zotin Berisha. Po kështu, sipas nenit 49 pika 3 e këtij ligji, të burgosurit kanë të drejtë të komunikojnë me median, e drejtë kjo që i mohohet z. Berisha. Të burgosurit kanë të drejtë të kenë takime konfidenciale, ndër të tjera, me deputetë (neni 49 pika 5). Të burgosurit kanë të drejtën e bisedave telefonike me të afërmit dhe të tretët (neni 49 pika 9).

28.9.3. Këto kufizime synojnë të pengojnë z. Berisha të takohet me anëtarët e partisë së tij dhe të drejtojë opozitën. Prandaj, pasojat e tyre ndikojnë jo vetëm në liritë politike të zotit Berisha, por edhe në të drejtat politike të partisë dhe të njerëzve që ajo përfaqëson.

29. Me qëllim zgjatjen e afatit të paraburgimit të z. Berisha përtej afatit ligjor, duke përdorur mjete ekstraligjore, gjyqtarja Maneku Gjoka ka shkelur afatet e KPP për t’i dhënë z. Berisha vendimin e

plotë të konfirmimit të masës së sigurimit personal brenda 48 orëve, siç parashikohet në nenin 248§2 të KPP^{xix}. Në shkelje të këtij afati, gjyqtarja Gjoka e ka dorëzuar vendimin e saj për arrest shtëpie vetëm më 9 janar 2024, pra 10 ditë pas shpalljes së tij. Kjo do të thotë se, jo vetëm z. Berisha është vënë në arrest shtëpie pa vendim gjykate për të paktën tetë (8) ditë, por është cënuar e drejta e tij e ankimimit të vendimit dhe procedurat e mëtejshme, pasi afati kohor i plotësimit të procedurave në Gjykatën e Apelit varet nga marrja e vendimit të plotë të arsyetuar të gjykatës së shkallës së parë.

30. Ky është një model i përsëritur që është zbatuar qëllimisht edhe në lidhje me vendimin nr.117, datë 26.10.2023, i cili u është dhënë avokatëve të z. Berisha më datë 13.11.2023, ose gjashtëmbëdhjetë (16) ditë pas afatit ligjor prej dyzet e tetë orësh, që përcakton neni 248§2 i KPP.

31. Në mënyrë të ngjashme, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit, nr.56, datë 21.11.2023, i gjyqtarës Iliriana Olldashi, i cili la në fuqi vendimet nr.112 dhe 117, iu dorëzua mbrojtësve të z.Berisha më datë 14.12. 2023, ose 13 ditë më vonë se afati 10 ditor i përcaktuar nga neni 249§6 i KPP^{xx}, duke cënuar kështu të drejtën e ankimit të z. Berisha në Gjykatën e Lartë.

32. Z. Berisha u mor në pyetje për herë të parë më 23.01.2024.

33. Gjatë kësaj periudhe hetimi, SPAK ka refuzuar të pranojë provat e paraqitura nga avokatët mbrojtës të z.Berisha, dërguar me disa memo shoqëruese të veçanta. Pavarësisht se ky është një rast hetimi mbi dyshime që lidhen me një vepër penale të spektrit financiar, SPAK dhe GJKKO kanë vendosur masën arrest shtëpie dhe masa të tjera sigurie pa bërë një analizë financiare nga ekspertë financiarë të licensuar. Berisha dhe Maltezi prezantuan një ekspertizë të kryer nga ekspertë të pavarur financiarë të licencuar, e cila vërteton pa asnjë dyshim se janë respektuar të gjitha ligjet mbi transparencën financiare, raportimin dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale, se të gjitha fitimet janë të ligjshme dhe se nuk ka pastrim parash. SPAK edhe në këtë rast nuk pranoi ta merrte këtë ekspertizë si provë në dosje.

III. Shkeljet procedurale të procedurave parlamentare dhe shkelje të tjera që cenojnë ushtrimin e mandatit të deputetit.

34. Në kundërshtim me standardet e një procesi të rregullt ligjor, anëtarët e Këshillit Parlamentar të Partisë Socialiste për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin nuk hezituan të shfaqnin paragjykimet e tyre publikisht përpara se të informoheshin me materialet dhe të merrnin një vendim mbi kërkesën e SPAK-ut për dhënien e autorizimit për vendosjen e masave të sigurisë ndaj zotit Berisha.

35. Miratimi i këtij vendimi politik u bë i ditur në media më datë 14.12.2023, përpara çdo diskutimi në këshillin përkatës apo seancën plenare, nga anëtari i këtij këshilli dhe kryetari i grupit

parlamentar të PS-së Bledar Çuçi, i cili deklaroi se Grupi i PS-së do të miratonte pa dyshim masat e kërkuara ndaj Berishës.

36. Një grup prej 30 deputetësh të grupit parlamentar të PD iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar interpretimin e kushtetutës nëse për vendosjen e masave shtrënguese të ndalimit të daljes jashtë shtetit dhe detyrim paraqitjes ndaj një deputeti ishte i nevojshëm autorizim *ex-ante* nga Kuvendi. Neni 134 i Kushtetutës^{xxi} parashikon qartë se një e pesta (1/5) e deputetëve të Kuvendit mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çdo çështje, përfshirë ato që nuk lidhen me interesat e tyre. Gjyqtarët kushtetues, shumica e të cilëve të emëruar në mënyrë të diskutueshme nga PS-ja, pas reformës problematike të drejtësisë, vendosën në kundërshtim me këtë normë kushtetuese, e cila ka qenë gjithmonë një gur themeli i të drejtave të opozitës në Shqipëri. Me vota të një, Gjykata vendosi se 1/5 e deputetëve nuk kishin të drejtë legjitime për të vënë në lëvizje gjykatën sepse nuk ishin palë në mosmarrëveshjen konkrete dhe se nuk u ishte marrë asnjë kompetencë^{xxii}.

37. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin përbëhej vetëm nga anëtarët e shumicës së PS-së dhe aleatët e tyre, sepse deputetët e opozitës kishin braktisur komisionet në protestë të uzurpimit të pushteteve të opozitës nga PS. Ndryshe nga ajo që përcaktohet në nenin 288§2 të KPP-së^{xxiii}, sipas të cilit prokurori detyrohet t'i paraqesë Kuvendit prova për të mbështetur kërkesën e tij për autorizim, si dhe ndryshe precedentë të tjerë kur janë dorëzuar mijëra faqe prova, kërkesa e SPAK-ut në rastin e Berishës nuk u shoqërua me asnjë provë. Në vend të kësaj, Kuvendit iu dhanë si arsytim për kërkesën vetëm vendimet antikushtetuese të gjykatave më të ulëta^{xxiv}.

38. Avokatët e z. Berisha theksua publikisht dhe paraqitën prova në mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin se SPAK ka fshehur prova që vërtetojnë qartë mungesën e çfarëdo veprë penale apo dëmi për financat publike.

39. Në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor dhe me nenin 118 të Rregullores së Kuvendit, prokurorët refuzuan t'u përgjigjen pyetjeve të mbrojtjes, duke shkelur kështu parimin e kontradiktoritetit dhe duke i mohuar z. Berisha të drejtën e tij të mbrojtjes. Përpjekjet e avokatëve mbrojtës për të ushtruar të drejtat e tyre u penguan vazhdimisht nga kryetarja e Kuvendit, znj. Nikolla, e cila në mënyrë të përsëritur shfaqti njëanshmërinë e saj, para se mbrojtja të kishte paraqitur të gjithë argumentet, duke thënë “ *Zoti Berisha duhet të shkojë atje, si çdo qytetar tjetër*”^{xxv}, si dhe duke e ndërprerë argumentet e mbrojtjes^{xxvi}.

40. Nën kryetarja e Kuvendit, deputete e PS-së dhe anëtarja e Këshillit, Ermonela Felaj, deklaroi gjatë mbledhjes së Këshillit se masat shtrënguese ishin të nevojshme sepse Berisha nuk po rrinte pasiv, por po grumbullonte njerëz para Kuvendit, duke nxjerrë në pah faktin se arsyeja e vërtetë e arrestimit të zotit Berisha ishte pengimi i opozitës në ushtrimin e të drejtave të saj legjitime^{xxvii}.

41. Po kështu zoti Alibeaj, anëtar i Këshillit të Mandateve, deputet i zgjedhur nga lista e PD-së, por që tashmë i është bashkuar linjës politike të PS-së, njëkohësisht partner i një prej gjyqtareve të Gjykatës Kushtetuese që votoi për këtë çështje me shumicën, i sugjeroi avokatëve mbrojtës që

të këshillonin klientin e tyre të hiqte dorë nga imuniteti, duke konfirmuar kështu njëanshmërinë e tij pa dëgjuar mbrojtjen. Duhet theksuar se autorizimi për të kryer një hetim ndaj deputetëve nuk është i nevojshëm (dhe nuk u kërkua as në këtë rast), sepse imuniteti në lidhje me hetimin u hoq nga Kushtetuta e Shqipërisë, pas propozimit të zotit Berisha në vitin 2012, kur ai ishte kryeministër. Autorizimi u kërkuar vetëm për caktimin e masave të sigurimit personal.

42. Vlen të theksohet se për rastin e Saimir Tahirit, ish-deputet i PS-së dhe ish-ministër i Brendshëm, Parlamenti dha autorizimin, me vendimin nr. 104/2017, datë 25.10.2017, pikërisht për të njëjtat masa të sigurimit personal– ndalim të daljes jashtë vendit dhe detyrim paraqitje.

43. Procedura për dhënien e autorizimit, e përcaktuar me nenin 118 të Rregullores së Kuvendit për Rregulloren dhe Procedurën, u shkel edhe gjatë seancës plenare të Kuvendit. Neni 118 parashikon që deputeti ndaj të cilit kërkohet masa ka të drejtën e fjalës në seancë plenare në mënyrë që deputetët e tjerë të marrin një vendim të informuar. Kryetarja e Kuvendit, znj.Nikolla (PS), futi në sallën plenare mbi pesëdhjetë (50) gardistë. Zoti Berisha kërkoi që gardistët të largoheshin nga salla që ai të fliste lirshëm. Znj. Nikolla, as që iu përgjigj kësaj kërkesë, por pretendoi se zoti Berisha nuk dëshironte të fliste dhe vazhdoi me miratimin e vendimit për dhënien e autorizimit.

44. Masa shtrënguese e arrestit në shtëpi dhe e ndalimit të komunikimit ka për qëllim kufizimin e lirive politike të z. Berisha, heqjen e mandatit të tij si deputet dhe pengimin e partisë kryesore opozitare – Partisë Demokratike të Shqipërisë, në vitin vijues zgjedhor.

45. Kushtetuta e Shqipërisë, neni 71§2^{xxviii} përcakton se mandati i deputetit ndërpritet nëse “(d) ai mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend; dh) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.”.

46. Më datë 15.1.2024, avokati i z. Berisha informoi SPAK-un për synimin e z. Berisha për të marrë pjesë në seancat plenare parlamentare, të cilat zakonisht zhvillohen një herë në javë. Në përgjigjen e datës 18.1.2024, nr. 1001/2, SPAK vendosi ndalimin e z. Berisha për të marrë pjesë në këto seanca, pavarësisht se kjo nuk ishte pjesë e kompetencave të SPAK.

47. Përkundrazi, neni 242 i KPP përcakton se ndaj një personi mund të caktohet pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik, a) vetëm me vendim të gjykatës, dhe se b) masa të tilla nuk mund të vendosen ndaj një personi të zgjedhur sipas ligjit elektorale^{xxix}. Më tej, kushtetuta, në nenin 71§2 (dh) vendos një standard më të lartë për kufizimin e ushtrimit të mandatit nga deputeti, pra edhe për pjesmarrjen në seancat plenare. Ky nen përcakton se mandati i deputetit mbaron (ndër shkaqe të tjera) kur ai shpallet fajtor për një krim, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

48. Z. Berisha kundërshtoi vendimin e SPAK-ut në Gjykatën Speciale (GJKKO), duke theksuar urgjencën e çështjes dhe duke i kërkuar gjykatës që të veprojë me shpejtësi. Gjykatësja Maneku Gjoka e caktoi seancën pas 8 ditësh, gjatë së cilës z.Berisha humbi mundësinë për të ndjekur seancën parlamentare. Z. Berisha kishte autorizuar siç duhet avokatët e tij për ta përfaqësuar atë në seancë. Njoftimi i gjykatës dhe ftesa ndaj z.Berisha për të marrë pjesë në seancën gjyqësore ishte firmosur nga një familjar që banon me të, sipas kërkesave të nenit 140 të KPP.

49. Gjyqtarja Maneku Gjoka pretendoi se nuk ishte e bindur se z. Berisha kishte njoftim për seancën gjyqësore dhe se qëllimi i tij për të mos marrë pjesë në gjykatë nuk ishte i qartë. Mbrojtësit e zotit Berisha konfirmuan se prokurat e firmosura nga zoti Berisha për ta kishin udhëzime të qarta për seancën dhe se bashkë me shënimin dhe nënshkrimin e familjarit të zotit Berisha nuk mbetej asnjë dyshim për dijeninë e zotit Berisha. Avokatët i tërhoqën vëmendjen gjyqtarës Maneku Gjoka për standardet e dyfishta që ajo aplikoi. Ndërsa ajo e merrte të mirëqenë se z. Berisha ishte vënë në dijeni ligjërisht për vendimin nr.112, datë 20.10.2023, vetëm për shkak se kishte mbajtur një konferencë për shtyp, pavarësisht se kjo nuk ishte një nga mënyrat ligjore të parashikuara nga KPP, ajo në këtë rast po refuzonte dokumentet e firmosura nga Z. Berisha, me të vetmin qëllim për të vonuar procesin. Gjyqtarja nuk pranoi gjithashtu kërkesën e avokatëve për përjashtimin e saj nga çështja dhe e shtyu seancën për një javë tjetër.

50. Synimi i një qasjeje të tillë është i qartë: të zgjasë sa më shumë, me mjete ekstra ligjore dhe në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë siç e kërkon Kushtetuta, ndalimin e vendosur nga SPAK ndaj z. Berisha për të marrë pjesë në parlament. Kjo qasje bie ndesh me KEDNJ, Protokollin 1, nenin 3, si dhe jurisprudencën e KEDNJ (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë* (nr. 2) [GC], 2020)^{xxx}.

51. Në datë 8 shkurt 2024 gjykatësja Maneku Gjoka dha shpallim vendimin për të mos lejuar pjesëmarrjen e z. Berisha në seancat plenare, në shkelje të nenit 242§2 i KPP dhe nenit 71 të kushtetutës. Deri në momentin e botimit të këtij raporti, z. Berisha nuk i është dhënë një kopje e vendimit në fjalë

Konkluzione.

Procedurat e ndjekura për caktimin e masave të sigurisë të arrestit në shtëpi dhe ndalimit të komunikimit ndaj kryetarit të PD-së, Sali Berisha, në fazën e hetimit, sikundër edhe vendosja në paraburgim dhe më pas në arrest shtëpie, e dhëndrit të tij Jamarbër Malltezi, pa i pyetur asnjëherë ata, bazohen në një sërë shkeljesh flagrante të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parimit të sigurisë juridike, atij të gjykimit të drejtë e një procesi të rregullt ligjor, të mishëruara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në dispozitat e Kushtetutës dhe kodeve të RSH. Ato janë një shfaqje flagrante e përdorimit të drejtësisë për goditjen dhe dobësimin e opozitës, si dhe largimin nga fusha politike të rivalit politik të Edi Ramës, Sali Berishës, përpara zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

ⁱ <https://www.youtube.com/watch?v=yDGnTwkhw0Y>
<https://www.youtube.com/watch?v=Kvy4FpSNAeE>

ⁱⁱ **KPP, neni 245 – Vendimi i gjykatës** (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 129):

“1. Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban, me pasojë pavlefshmërie: a) gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë dhe, kur është e mundshme, tregimin e vendit ku ndodhet; b) parashtrimin përmbledhës të fakteve, duke treguar nenet e ligjit që konsiderohen të shkelura; c) parashtrimin e shkaqeve të posaçme dhe të të dhënave që përlligjin masën e sigurimit; ç) parashtrimin e shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimi i papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit, kur caktohen masat e sigurimit shtrënguese të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të këtij Kodi; d) caktimi i kohëzgjatjes së masës, kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës; dh) datën, nënshkrimin e kryetarit, të sekretarit që e asiston dhe vulën e gjykatës.

2. Kur vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, gjykata disponon në një vendim, duke arsyetuar kushtet dhe kriteret për secilin prej tyre.”

ⁱⁱⁱ**KPP, neni 228 - Kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal** (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 121): “1. Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. 2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie të shuarjes së veprës penale ose dënimit. 3. Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

KPP, Neni 229 - Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017): “1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal. 3. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh interesin e tij më të lartë dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset educative konkrete.”

^{iv}**Kushtetuta, neni 73** - “1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes. 2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit. 3. Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës. 4. Për çështjet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur.”

^v**Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, neni 13§5**: “5. Këshilli shqyrton kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin, ose heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme, ose ushtrimin e kontrollit personal apo të banesës së një deputeti në përputhje me nenin 73 të Kushtetutës. Shqyrtimi i kërkesës bëhet sipas procedurës së parashikuar në nenet 118 dhe 119 të kësaj Rregulloreje.”

^{vi}**Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, neni 118 – Dhënia e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, për kontrollin personal ose të banesës**: “1. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, për kontrollin personal ose të banesës i paraqitet Kryetarit të Kuvendit nga prokurori. Kryetari ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet dhe vë në dijeni deputetin. 2. Deputeti, për të cilin kërkohet dhënia e autorizimit, lajmërohet për kërkesën e bërë dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha në të cilën Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës. Deputeti ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes, të përfaqësohet me mbrojtës ligjor, të drejtojë pyetje dhe të kërkojë sqarime në lidhje me kërkesën me qëllim të ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes. 3. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli, brenda 2 javëve harton një raport për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës. Raporti i Këshillit u shpërndalet deputetëve. 4. Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo të kontrollit personal ose të banesës të një deputeti vendoset si pikë e parë e rendit të ditës të seancës

pasardhëse, pas paraqitjes së raportit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Në seancë plenare fjala i jepet në fillim deputetit, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, për të dhënë shpjegime ose për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Raporti i Këshillit nuk është objekt diskutimi. Kuvendi vendos me votim të hapur për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës ndaj deputetit. 5. Në rastin kur Kuvendi nuk merr vendim për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës të një deputeti brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse, atëherë kërkesa konsiderohet e rrëzuar nga Kuvendi. 6. Përcaktimet e bëra në këtë nen zbatohen edhe në rastet e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës të anëtarit të Këshillit të Ministrave.”.

vii <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/K--shilli-p--r-Rregulloren-dhe-Mandatet-dat---20-10-2017.pdf>

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Keshilli-i-Rregullores-Mandateve-dhe-Imunitetin-date-21.10.2017.pdf>

viii **KPP, neni 246 - Zbatimi i masave të sigurimit** (*Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 130*):

“1. Oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe e njeh menjëherë me letrën e të drejtave, sipas paragrafit 2, të nenit 34/b, të këtij Kodi. Policia gjyqësore mban procesverbal për veprimet e kryera. Procesverbali i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit. 2. Në rast se dyshohet për vërtetësinë e vendimit që ka caktuar masën e sigurimit ose për vërtetësinë e identitetit të personit ndaj të cilit është dhënë masa, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të ngarkuar nuk e zbatojnë atë. 3. Vendimet për masat e tjera të sigurimit i njoftohen të pandehurit nga gjykata. 4. Pas njoftimit ose zbatimit të tyre, vendimet depozitohen në sekretarinë e gjykatës që i ka dhënë. Për depozitim njoftohen edhe mbrojtësit. 5. Kopja e vendimit, me të cilin është caktuar një masë ndaluese i dërgohet organit që është kompetent për të vendosur caktimin e një mase të tillë në rastet e zakonshme. 6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi.”.

ix **Kushtetuta, neni 145** – “1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. 2. Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat. 3. Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit.”.

x **KPP, Neni 17 – Heqja dorë** (*Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 13*): “1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij; b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërit prej palëve private; d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale; dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim; e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie. 2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse i cili e miraton ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar. 3. Mbi deklarin e heqjes dorë të kryetarëve të gjykatave vendosin kryetarët e gjykatave të një shkalle më lart. Mbi deklarin e heqjes dorë të kryetarit të Gjykatës së Lartë vendos një trup gjykues i Gjykatës së Lartë i përbërë nga tre gjyqtarë.”.

KPP, Neni 18 - Përjashtimi i gjyqtarit : “1. Palët mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit: a) në rastet e parashikuara nga nenet 15, 16 dhe 17; b) kur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe para se të jetë dhënë vendimi ai ka shfaqur mendimin e tij mbi faktet ose rrethanat objekt procedimi. 2. Gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë

pjesë në dhënien e vendimit derisa të jepet vendimi që e deklaron të papranueshme ose që e rrezon kërkesën e përjashtimit.”.

^{xi} **Kushtetuta, neni 31** : “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij; b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;...”.

KPP, neni 34/a – Të drejtat e të pandehurit – (*Shtuar me Ligjin Nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 26*): “1. Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë: ...e) të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen; ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi;...”

KPP, neni 248 - Marrja në pyetje e personit të arrestuar (*Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 132*) – “1. Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese, gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës. Mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre. 2. Nëpërmjet marrjes në pyetje, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në të kundërt, gjykata vendos vazhdimin e zbatimit të saj. Gjkata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 48 orëve.”.

^{xii} **Ligji 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”**

Neni 3 - Parimet : "1. Profesionin e avokatit udhëhiqet nga parimet bazë të profesionalizmit, etikës, besnikërisë, integritetit dhe konfidencialitetit. 2. Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit, udhëhiqet në mënyrë parësore nga interesat e klientit që përfaqëson."

Neni 8 "Detyrat e avokatit" - "Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit, kryen detyrat e mëposhtme: a) i siguron çdo klienti që përfaqëson mbrojtje profesionale, të drejtë dhe efektive në funksion të realizimit me besnikëri të interesave të tij; b) i ofron çdo klienti shërbim ligjor të barabartë, duke i garantuar mbrojtje pa asnjë diskriminim të çdo forme, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi; c) vepron me profesionalizëm, besnikëri, ndershmëri dhe dinjitet, si dhe udhëhiqet nga interesat e klientit, në respekt të legjislacionit në fuqi, Statutit të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, si dhe rregullave të Kodit Etik të Avokatit; ç) garanton mbrojtje ose përfaqësim transparent, në interesin më të mirë të klientit që përfaqëson, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesit; d) ofron shërbime ndaj personave përfituese të ndihmës juridike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti; dh) ofron shërbimin e avokatisë në çdo rast mbi bazën e një marrëveshjeje me shkrim të lidhur midis tij dhe klientit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil. Nëse klienti vendos të zgjidhë marrëveshjen në çdo fazë të zbatimit të saj, avokati është i detyruar ta respektojë vendimin e klientit dhe të kërkojë shpërblim për punën e kryer deri në momentin e zgjidhjes së marrëveshjes. Kur shpërblimi nuk caktohet me mirëkuptim midis palëve, çështja mund të zgjidhet në rrugë gjyqësore; e) detyrohet të kthejë çdo dokumentacion të siguruar nga klienti në funksion të përfaqësimit ose mbrojtjes me përfundimin e marrëveshjes ndërmjet avokatit dhe klientit; ë) deklaron pranë Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë çdo ndryshim të të dhënave personale të depozituara, ndryshime të tjera në lidhje me gjendjen gjyqësore, si dhe fillimin e ushtrimit të detyrave apo funksioneve publike ose private; f) merr masat e nevojshme në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë profesionale, sipas rregullave të përcaktuara në Statutin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë; g) raporton për çdo dyshim të lindur në lidhje me masat e vigjilencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; gj) informon klientin për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, kur e vlerëson të arsyeshme dhe në interes të klientit; h) informon viktimën e veprës penale, për të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.”.

^{xiii} **KPP, neni 6 – Sigurimi i mbrojtjes** (*Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 3*): “1. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat në rastet e parashikuara nga ky Kod. 2. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t’i garantohen të drejtat procedurale dhe t’i ruhen interesat e tij ligjore.”.

^{xiv} **KPP, Neni 231 - Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal**: - “1. Në rast shkelje të detyrimeve që lidhen me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese.”.

^{xv} **KPP, Neni 232 Llojet e masave shtrënguese:** “1. Masat shtrënguese janë: a) ndalimi i daljes jashtë shtetit; b) detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore; c) ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar; ç) garancia pasurore; d) arresti në shtëpi; dh) arresti në burg; e) shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.”.

^{xvi} **KPP, Neni 128/a - Pavlefshmëria absolute** (Shtuar me Ligjin Nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 71): “1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: a) kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e trupave gjykues, sipas parashikimeve të këtij Kodi; b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim; c) thirrjen e të pandehurit, viktimës ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme. 2. Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm.”.

^{xvii} **KPP, Neni 18 - Përrjashtimi i gjyqtarit:** “1. Palët mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit: a) në rastet e parashikuara nga nenet 15, 16 dhe 17; b) kur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe para se të jetë dhënë vendimi ai ka shfaqur mendimin e tij mbi faktet ose rrethanat objekt procedimi. 2. Gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit derisa të jepet vendimi që e deklaronte të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përjashtimit.”.

^{xviii} **Kushtetuta e Shqipërisë, neni 17 :** “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”.

^{xix} **KPP, neni 248§2 – Marrja në pyetje e personit të arrestuar:** “ 2. Nëpërmjet marrjes në pyetje, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në të kundërt, gjykata vendos vazhdimin e zbatimit të saj. Gjykata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 48 orëve.”.

^{xx} **KPP, neni 249§6 - Ankimi ndaj masave të sigurimit** (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 133): “6. Gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit. Gjykata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 10 ditëve.”.

^{xxi} **Kushtetuta e Shqipërisë, neni 134,** (ndryshuar me ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 12): “1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: a) Presidentit të Republikës; b) Kryeministrit; c) jo më pak se një të pestës së deputetëve; ç) Avokatit të Popullit; d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit; dh) çdo gjykatë, sipas neni 145, pika 2, të kësaj Kushtetute; e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta; ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë; f) organeve të qeverisjes vendore; g) organeve të bashkësive fetare; gj) partive politike; h) organizatave; i) individëve. 2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.”.

^{xxii} <file:///C:/Users/HP/Downloads/vend.mosk.27323%20Gjykata%20kushtetuese.pdf>

^{xxiii} **KPP, neni 288** (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 149): - “1. Kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi. 2. Kërkesa për autorizim paraqitet kur plotësohen kushtet ligjore të parashikuara në këtë Kod për kryerjen e veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Ajo shoqërohet me një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën e tij. 3. Kur deputeti është arrestuar në flagrancë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin. Kur Kuvendi vendos heqjen e masës së arrestit në flagrancë, deputeti lirohet menjëherë.”

^{xxiv} <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202312201532041442Keshilli%20i%20mandateve%20-%202018.12.2023.pdf>

^{xxv} <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202312201532041442Keshilli%20i%20mandateve%20-%202018.12.2023.pdf> Faqe 46-47

^{xxvi} Idem, faqe 49.

^{xxvii} <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202312201532041442Keshilli%20i%20mandateve%20-%202018.12.2023.pdf> Faqe 70-71

^{xxviii} **Kushtetuta, neni 71:** “1. Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve. 2. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit: a) kur ai nuk bën betimin; b) kur

heq dorë nga mandati; c) kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 69, 70 paragrafët 2 dhe 3; ç) kur mbaron mandati i Kuvendit; d) kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend; dh) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.”

^{xxx} **KPP , neni 242 - Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik:** 1. Me vendimin që disponon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, gjykata i ndalon përkohësisht të pandehurit, plotësisht ose pjesërisht, veprimtarinë që lidhet me to. 2. Kjo masë nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektorale.”

^{xxx} “Në *Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2) [GC], 2020* , Gjykata vendosi për herë të parë mbi një ankesë sipas nenit 3 të Protokollit Nr. 1 në lidhje me efektet e paraburgimit të deputetëve të zgjedhur në ushtrimin e detyrave të tyre parlamentare. Duke theksuar se caktimi i një mase që i heq lirinë një deputeti, ose vazhdimi i paraburgimit, nuk përbën automatikisht shkelje të nenit 3 të Protokollit nr., gjykata vlerësoi të gjitha interesat përkatëse, veçanërisht ato të mbrojtura nga neni 3 i Protokollit Nr. Rëndësia e lirisë së shprehjes së deputetëve (veçanërisht të opozitës) ishte e tillë që, kur ndalimi i një deputeti ishte i papajtueshëm me nenin 10, do të konsiderohej gjithashtu si shkelje e nenit 3 të Protokollit nr. 1. Një element tjetër i rëndësishëm ishte nëse akuzat ishin të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë politike të një deputeti. Për më tepër, duhej të ofrohej një mjet juridik me të cilin deputetët mund të kundërshtonin në mënyrë efektive ndalimin e tyre dhe të shqyrtonin ankesat e tyre në themel. Për më tepër, kohëzgjatja e paraburgimit të një deputeti duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur, dhe gjykatat vendase duhet të shqyrtojnë realisht masat alternative të paraburgimit dhe të japin arsyet pse masat më pak të rënda konsiderohen të pamjaftueshme. Në këtë kontekst, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer një vepër penale, siç kërkohet nga neni 5 § 1, është po aq e rëndësishme për qëllimet e nenit 3 të Protokollit nr. 1. Gjykatat vendase nuk kishin marrë parasysh siç duhet të gjitha të këtyre elementeve dhe për të marrë parasysh efektivisht faktin se kërkuesi ishte jo vetëm deputet, por edhe drejtues i opozitës, kryerja e detyrave parlamentare të së cilës kërkonte një nivel të lartë mbrojtjeje. Megjithatë aplikanti e mbajti vendin e tij gjatë gjithë mandatit të tij, ishte praktikisht e pamundur për të që të merrte pjesë në aktivitetet parlamentare. Prandaj, paraburgimi i tij i pajustificuar ishte i papajtueshëm me thelbin e të drejtës së tij sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 për t'u zgjedhur dhe për t'u ulur në Parlament.”

https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Guide_Art_3_Protocol_1_ENG , fq 26.